



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim për shtyp

Sot, në datë 19.05.2022, në mjediset e Autoritetit të Konkurrencës, u zhvillua takimi ndërmjet Kryetarit të Autoritetit të Konkurrencës (AK) dhe përfaqësuesve të Shoqatës Gjermane për Bashkëpunim Ndërkombëtar - GIZ, në kuadër të projektit SANECA, i cili ofron mbështetje për përgatitjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Evropian.

Kjo mbështetje, do të ofrohet ndaj Autoritetit të Konkurrencës, si lider i kapitullit 8 të MSA, në lidhje me (i) procesin e negociatave, (ii) hartimin/zbatimin e dokumentave strategjike (përfshi hartim legjislativ), dhe (iii) përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e negociatave.

Në vijim të diskutimeve, Kryetari i AK iu kërkoi përfaqësuesve të GIZ asistencë në lidhje me forcimin e kapaciteteve institucionale në fushën e procesit të integritetit; procesit të diskutimeve dhe përgatitja për procesin e negociatave; zhvillimit të aftësive raportuese lidhur me procesin e integritetit dhe procesin e përafrimit të legjislativit shqiptar në fushën e konkurrencës me *acquis* të BE-së, etj.

Nga ana e përfaqësuesve të GIZ u shpreh mbështetje e plotë për krijimin e një bashkëpunimi sa më të frytshëm e konkret.